



REPUBLIKA E KOSOVËS - ZYRA E PRESIDENTES
REPUBLIC OF KOSOVO - OFFICE OF THE PRESIDENT
REPUBLIKA KOSOVO - KANCELARIJA PREDSEDNICE

Datë: 16.04.2026

THIRRJE PUBLIKE

Për një përfaqësues nga grupi i ekspertëve të jashtëm për shprehje të interesit për të qenë pjesë e Komisionit të Vlerësimit për ndarjen e mjeteve financiare nga kategoria e subvencioneve në Presidencë.

Bazuar , në nenin 8 (3.2) të Rregullores MF-Nr. 04/2017 për kriteret, standardet dhe procedurat e financimit publik të OJQ-ve, ftojme ekspertët e pavarur, me përvojë për shqyrtimin dhe vlerësimin e aplikacioneve, të aplikojnë për të marrë pjesë në komisionin e vlerësimit, në cilësinë:

- ekspert/njohës i fushës për shqyrtimin dhe vlerësimin e aplikacioneve të OJQ-ve dhe personave fizik.

Të drejtë aplikimi kanë:

- ekspertë të jashtëm/njohës të fushave për shqyrtimin dhe vlerësimin e aplikacioneve të OJQ-ve dhe personave fizik me të paktën pesë (5) vite përvojë pune në hartimin dhe menaxhimin e projekteve, ose fusha të ngjashme.

Kandidatët duhet të plotësojnë këto kushte:

- duhet të kenë të paktën nivelin e studimeve themelore universitare – Bachelor;
- duhet të kenë përvojë pune relevante;
- nuk duhet të jenë të emëruar politik, nëpunës civil ose në pozita të ngjashme në administratën publike.

Aplikantët duhet të dorëzojnë këto dokumente:

- një CV;
- dëshmi për shkollimin dhe përvojën e punës;

Përfaqësuesi/ja i/e lartpërmendur do të jetë anëtarë i Komisionit të Vlerësimit për ndarjen e mjeteve financiare nga kategoria e subvencioneve në Presidencë.

Aplikimi mund të bëhet përmes e-mail: subvencione.zprk@president-ksgov.net deri me datën 29.04.2026 dhe të shkruhet në subjekt pozita për anëtar të komisionit për të cilën aplikoni.